

VENDIM
Nr. 107, datë 13.2.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
PUNËVE TË JASHTME, PËR PAGESËN E KONTRIBUTEVE FINANCIARE TË NATO-S PËR
SELINË E RE, PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 10 100, datë 26.3.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në traktatin e Atlantikut të Veriut” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, t’i shtohen fondet për pagesën e kontributeve financiare të fondeve të përbashkëta të NATO-s, respektivisht në shumat, si më poshtë vijon:

a) Për “Fondin e përbashkët”, për vitin 2012, për ndërtesën e re të selisë së NATO-s, në vlerën 100 415 (njëqind mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë) euro, e barasvlershme me vlerën në lekë.

b) Për “Fondin kombëtar”, për vitin 2012, për ndërtesën e re të selisë së NATO-s, në vlerën 418 943 (katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e tre) euro, e barasvlershme me vlerën në lekë.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha